

## STATUT i Shoqerise tregtare TWINZZ-FF SHPK

Sot me date 20 / 09 / 2021

### Kreu I

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

#### Forma ligjore dhe emri i shoqerise

- 1.1. **TWINZZ-FF SHPK** eshte themeluar bazuar ne ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe ne Aktin e Themelimit te Shoqerise nenshkruar nga Ortaku i Vetem.
- 1.2. **TWINZZ-FF SHPK** eshte themeluar dhe funksionon si shoqeri tregtare e formes "me pergjegjesi te kufizuar" (sh.p.k). Nga ketu e meposhte ne kete Statut shoqeria **TWINZZ-FF SHPK** do referohet shkurtimisht Shoqeria.
- 1.3. Shoqeria fiton personalitetin juridik si dhe te drejten per te kryer veprime dhe te marre persiper te drejta dhe detyrime gjate aktivitetit te saj te perditshem, qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.
- 1.4. Shoqeria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit te perezaktuar ne kete Statut, bazuar ne Legjislacionin Shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

##### Neni 2

#### Ortaket e shoqerise

- 2.1. Shoqeria eshte themeluar nga nje Ortak i vetem, **Z. Fuat Lika**
- 2.2. **Z. Fuat Lika**, si ortak i vetem, pergjigjet per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj.

##### Neni 3


#### Kohezgjatja

- 3.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.
- 3.2. Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund te shkurtohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ky Statut.

##### Neni 4

#### Selia

- 4.1. Selia e Shoqerise **TWINZZ-FF SHPK** eshte ne adresen: Tirane, Njesi, Nr. ZK. 8330, VOL 49, Faqe 188, Nr. pas. 8/429-N/2
- 4.2. Shoqeria mund te vendose te hape dege, filiale apo zyra perfaqesie ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj.



**Neni 5**  
**Objekti i aktivitetit**

Objekti i aktivitetit te shoqerise **TWINZZ-FF SHPK** do te jete:

- **Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jo-banke AK-INVEST sh.a.**
- **Siguracione**
- **Tobacco shop**

**Kreu II**

**KAPITALI DHE KUOTAT**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **TWINZZ-FF SHPK** eshte 2.500.000 (dy milion e peseqind mije) Leke.
- 6.2. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote.
- 6.3. Vlera nominale e nje kuote eshte 2.500.000 (dy milion e peseqind mije) Leke
- 6.4. Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre.
- 6.5. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere.
- 6.6. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

**Neni 7**

**Regjistri i kuotave te kapitalit themeltar**

- 7.1. Kuotat dhe zoteruesi i tyre, si dhe te dhena te tjera qe lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen ne nje regjister te posacem.
- 7.2. Forma dhe modalitet e tjera te regjistrimit miratohen me vendim te Ortakut te vetem.
- 7.3. Ne rast te zoterimit te kuotave te shoqerise nga me shume se nje ortak forma dhe modalitet e tjera te ketij regjistri miratohen me vendim te ortakeve qe zoterojne me shume se 3/4 e kuotave.

**Neni 8**

**Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnet te ortakut**

- 8.1. Ortaku i vetem mundet te transferoje lirisht tek te tretet, pjeserisht ose teresisht, pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise.
- 8.2. Ne rast se ne nje moment te caktuar pjeset e kapitalit themeltar .te shoqerise zoterohen nga me shume se nje ortak, transferimi i ketyre pjeseve brenda shoqerise mundet te behet lirisht ndersa transferimi tek personat e trete mund te behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.



### **Neni 9**

#### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi**

- 9.1. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuese ne kete Statut, nepermjet trashegimise, si dhe midis bashkeshorteve ne rast ndarje pasurore.
- 9.2. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuese ne kete Statut, midis bashkeshorteve si dhe midis prindit dhe femijes ose anasjelltas.

### **Neni 10**

#### **Akti i transferimit pjeseve te kapitalit themeltar**

- 10.1. Ne cdo rast transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet te vertetohet nepermjet nje akti noterial.
- 10.2. Trasferimet e pjeseve te kapitalit themeltar pasqyrohen ne regjistrin e posacem te miratuar sipas nenit 8 te ketij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar ne kete regjister, nuk e ben te pavlefshem aktin e transferimit.
- 10.3. Akti i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te depozitohet ne Regjistrin Tregtar jo me vone se nje muaj nga data e regjistrimit te ketij akti ne zyren noteriale perkatese.
- 10.4. Kerkesa per depozitimimin e aktit te shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar mundet te behet nga shitesi ose nga bleresi, ose prej perfaqesuesve te tyre te autorizuar.

### **Neni 11**

#### **Zmadhimet e kapitalit me ane te kontributeve ne para**

- 11.1. Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet me kontribute ne para me vendim te ortakut te vetem.
- 11.2. Zmadhimi sipas pikes 1 te ketij neni behet me shlyerjen teresisht te vleres se shtuar prej Ortakut te vetem.
- 11.3. Shlyerja e fondeve mund te vertetohet nga nje zyre noteriale ose nepermjet nje konferme bankare.
- 11.4 Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit te fondeve, Ortakut te vetem i lind e drejta te terheqe fondet e depozituara.

### **Neni 12**


#### **Zmadhimi i kapitalit me ane te kontributeve ne natyre**

- 12.1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nepermjet kontributeve ne natyre behet me vendim te Ortakut te vetem.
- 12.2. Vlera e kontributit ne natyre si shtese e kapitalit themeltar percaktohet nga nje ekspert i cili emerohet nga Ortaku i vetem.
- 12.3. Te dhenat mbi kontributin ne natyre te shtuar si pjese e kapitalit themeltar pasqyrohen ne Statut dhe regjistrohen ne Regjistrin Tregtar. Ne rast te kundert zmadhimi konsiderohet i pa bere.

### **Kreu III**

#### **ORGANET DREJTUESE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE**

#### **Neni 13 Organet drejtuese**



Organet drejtuese te shoqerise **TWINZZ-FF SHPK** jane:

- a. Ortaku i vetem
- b. Administratori

#### **Neni 14**

##### **Ortaku i vetem, kompetencat**

14.1. Ortaku i vetem ka keto kompetenca:

- a. ndryshimet ne dispozitat e statutit ka keto kompetenca:
- b. caktimi dhe shkarkimi i administratorit;
- c. caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/eksperteve kontabel si dhe likuidatorit/likuidatoreve;
- d. miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit;
- e. miratimi i raportit vjetor;
- f. shperndarja e dividendeve;
- g. ndryshimi i kapitalit themeltar;
- h. transferimi i kuotave te kapitalit themeltar tek palet e treta;
- i. likuidimi dhe/ose shnderrimi i shoqerise. ne nje forme tjeter

#### **Neni 15**

##### **Administratori**

15.1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- e. Miraton pagat mujore te gjitha kategorive te punemarresve, ne përputhje me tabelen e pagave te miratuar

15.2. Mandati i Administratorit të shoqërisë është 5 (pesë vjet) me të drejtë rizgjedhjeje.

15.3. Administrator i shoqërisë është **Z. Fuat Lika**

**ORTAKU I VETEM**

**Z. Fuat Lika**

